



VENDIM
Nr. 22 Datë 08.02.2010

PËR
MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE ME NR. 2387 MIDIS OST SH.A DHE EFT SH.P.K

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës “V” të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.06.2008, pikës 4.13 gërma “A” pika 3, pikës 7 gërma “g”, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me VKM nr. 338, date 19.03.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 08.03.2010, pasi shqyrtoi relacionin e përparit nga Drejtorite Teknike të ERE-s dhe marrëveshjen e transmetimit të energjisë elektrike me nr. 2387 midis OST sh.a dhe EFT sh.p.k,

Konstatoi se:

- Palët e kësaj kontrate OST sh.a dhe EFT sh.p.k janë subjekte të licensuara nga ERE respektivisht me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 24, datë 26.03.2009, për aktivitetin e transmetimit dhe me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 53, datë 03.08.2009, për aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar.
- Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me Modelin e Tregut të Energjisë miratuar me VKM nr.338 date 19.03.2008 , Rregullat e Tregut të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.68, datë 23.06.2008, të ndryshuar, si dhe me Vendimin e ERE-s nr. 96 date 15.12.2009 “ Për përcaktimin e tarifës

se transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a për periudhën 1 janar -31 dhjetor 2010.

- Modeli i Tregut vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këto natyre kontrate.

Për gjithë sa me sipër Bordin e Komisionerëve,

Vendos:

1. Miratimin e marrëveshjes së transmetimit të energjisë elektrike me nr. 2387 midis OST sh.a dhe EFT sh.p.k, me ndryshimet si më poshtë:
Në fund të paragrafit të pikës 14 të kontratës të shtohet shprehja: ***“me miratimin e ERE-s”***.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari i ERE-s
Bujar Nepravishta**

—
Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta” Nr.10
963
Tirane
69 590
E-mail erealb@ere.gov.al

Tel/Fax +355 42 22

Tel +355 42

www.ere.gov.al